

# Curriculum Vitae

## Lule Elezi

Profesor i rregullt

Fakulteti i Arteve, Dega e Artit Muzikor

e- mail: [lule.elezi@uni-pr.edu](mailto:lule.elezi@uni-pr.edu)

E dalluar për lojën e saj të fuqishme, aq edhe delikate (Shtëpia Diskografike FCE – Luxembourg), e cilësuar si virtuoze në interpretim (Momag - Austri), e vlerësuar për interpretim me shumë zemër të krijimtarisë së kompozitorit Frederic Chopin (Bergedorfer Zeitung – Gjermani), Lule Elezi mori vëmendje të madhe nga mediat botërore për interpretimin e saj. Ajo vlerësohet lartë për interpretimin e repertorit të periudhës klasike dhe romantike me një fokus dhe sens të veçantë në veprat e kompozitorëve të mëdhenj të pianos si Beethoven, Chopin, Schuman dhe Schubert.

Si fëmijë me talent të madh, udhëtimi muzikor i Lule Elezit filloi në moshën shtatë vjeçare, kur nëna e saj, mësuese e pianos i dha Lules mësimet e para në instrumentin e pianos. Talenti, puna e palodhur dhe dashuria për instrumentin e bënë Lule Elezin të ndiqte zhvillimin e teknikës interpretuese në shkollën e ulët dhe të mesme të muzikës në qytetin e Prizrenit. Gjatë kësaj periudhe Elezi mori pjesë në shumë konkurse/gara për instrumentin e pianos të organizuara në ish-Jugosllavi ku dhe u shpërblye me çmime të para dhe të dyta. Që atëherë, një vend i veçantë në skenën performuese vendore ishte i garantuar për të.

Lule Elezi studimet universitare i ndoqi në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Arteve, Dega e Artit muzikor – Piano. Rezultatet e shkëlqyera të treguara gjatë studimeve të saj, bënë që Elezi të vlerësohet si "Student i dalluar" dhe në të njejtën kohë të fillojë punën në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" - Fakulteti i Arteve, Dega e Artit Muzikor.

E lindur në Kosovë, një vend i cili ka kaluar nëpër shumë rrethana të vështira politike Elezi përfundoi studimet e saj profesionale në një kohë kur studentët shqiptarë u përjashtuan nga institucionet formale arsimore. Këto institucione u zëvendësuan nga të ashtuquajturat "shkollat shtëpi" të cilat në fakt ishin shtëpi private familjare që u vunë në dispozicion

vullnetarisht për përdorimin e studentëve në atë kohë. Aktivitetet koncertale të kohës realizoheshin fshehurazi brenda kishave të vendit dhe gjithashtu në ndërtesën e Shoqatës së Kompozitorëve të Kosovës.

Duke pasur parasysh këtë situatë, Elezi ishte e detyruar të vazhdonte shkollimin e saj profesional në vendet fqinje si Shqipëria, ku dhe përfundoi specializimin e saj dy-vjeçar për piano në Akademinë e Arteve të Bukura në Tiranë, në klasën e prof. Anita Tartari. Studimet dy vjeçare të magistraturës Elezi i përfundoi në Akademinë e Muzikës në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë në klasën e Profesor Svetlana Chlaidze. Kjo, megjithatë, nuk e ndaloi atë të 'thyejë akullin' dhe të ndiqte karrierën e saj ndërkombëtare të cilën e arriti për kohë të shkurtër si rezultat i talentit dhe punës së saj të palodhur.

Mbështetja e jashtëzakonshme e Prof. Dr. Theodor Kanitzer - president i Shoqatës Ndërkombëtare të Shopenit në Vjenë dhe Prof. Dr. Johann Günther - nënkryetar i Shoqatës së Shopenit në Vjenë, hapi 'derën e madhe' për karrierën ndërkombëtare të Elezit në Evropë dhe përtej. Kjo rezultoi gjithashtu në realizimin e shumë recitaleve në Vjenë, si dhe në festivalin e njohur F. Chopin në Kartause in Gaming në Austri, organizuar nga Shoqata Ndërkombëtare e F. Chopin në Vjenë.

Por ky ishte vetëm fillimi i karrierës së saj shumë të suksesshme ndërkombëtare. Një seri e ngjeshur e aktiviteteve koncertale përveç Kosovës, e dërgon Elezin në skena dhe institucione të njohura Evropiane si Kolegji Mbretëror i Muzikës në Stokholm në Suedi, por edhe me recitale pianistike në Frankfurt, Hamburg, Storkow (Mark), në Eberswalde, Potsdam dhe Berlin të Gjermanisë. Lule Elezi mbajti koncerte edhe në Luksemburg, në Strasburg - Francë, Sofje - Bullgari, në Shqipëri, Kroaci dhe në Itali. Krahas Evropës, Elezi zgjeroi serinë e saj të koncerteve edhe në New York në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Azi ku përfshihen dy koncerte recitale në Wuhan - Kinë, një koncert në Tokio - Japoni dhe koncert recital në Shën Petersburg - Rusi.

Është shumë e rëndësishme të theksohet bashkëpunimi me Orkestrën Simfonike të Radio Televizionit Shqiptar, me të cilin ajo mbajti dy koncerte si soliste në piano. Elezi koncertoi si soliste në piano edhe me Orkestrën Simfonike të Filharmonisë së Kosovës, nën drejtimin e dirigjentëve Toshio Yanagisawa (Japoni) dhe Boian Videnoff (Gjermani).

E dalluar për aktivitetin e ngjeshur koncertal jashtë Kosovës, kritikët e mediave ballkanike dhe ndërkombëtare i japin Elezit epitelin e përfaqësueses më të shquar të skenës profesionale performuese vendore. Lule Elezi sot është një nga ambasadoret më të besueshme dhe më të vlerësuara të shtetit të saj të “sapolindur” dhe si e tillë ajo paraqet vlerë të përhershme për Kosovën në Evropë dhe botë.

Vizioni i saj i qartë për botën pianistike është një pasqyrim i ndjenjave të thella individuale të cilat transmetohen lehtësisht, me një puls të qetë, shumë vetbesim dhe pjekuri edhe tek dëgjuesit. E gjithë kjo rezultoi në një ngritje të shpejtë dhe të qëndrueshme të famës së saj.

Një përkushtim të madh, krahas aktivitetit solistik, Lule Elezi i dedikon muzikës kamertale, duke krijuar ansamble por edhe duke shoqëruar artistë vendas dhe ndërkombëtar, bashkëpunime të cilat rezultojnë mjaft të frytshme. Elezi u jep një mbështetje të madhe artistëve të rinj jo vetëm me shoqërimin e saj në piano, por edhe me promovimin e tyre, duke u lehtësuar kontaktin me skenën dhe sfidat e interpretimit.

Si soliste por edhe si shoqëruese ajo arrin të ruaj hirin dhe shkëlqimin e saj në të gjitha performancat. Përmes performancës së saj publiku do të kuptojë shpirtin e saj të ndjeshëm, emocional por edhe luftarak. Në regjistrimin e CD-së së Elezit, ju do të vini re një pianiste e cila zotëron stilet, duke i bashkuar ato në stilin origjinal të interpretimit, gjithmonë me kontroll dhe hollësi.

Lule Elezi aktualisht është duke punuar si profesor i rregullt në lëndët Piano – lëndë kryesore, Metodikë e pianos, Duo pianistik dhe Korepetim në Fakultetin e Arteve – Dega e Artit Muzikor, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Ajo është një pianiste e shkëlqyer me një ambicie të pashtershme për të zotëruar literaturën pianistike me performancë të fuqishme dhe me shpirt.

**Prof. asis. Dr. Rreze Kryeziu Breznica - Muzikologe**

## Aktiviteti koncertal:

- Publikimi i CD-së me vepra të njohura të kompozitorëve botëror L. van Beethoven dhe F. Chopin të regjistruara në “Mozart Hause” , Vjenë - Austri, 2020.
- Koncert recital, Lubjanë – Slloveni, 2020.
- Soliste dhe shoqëruese në piano në Akademinë solemne për nder të 50 vjetorit të themelimit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Prishtinë - Republika e Kosovës, 2019.
- Koncert kamertal organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë - Republika e Kosovës, 2019.
- Koncert solistik me Orkestrën Simfonike të Filharmonisë së Kosovës, me dirigjent Boian Videnoff (Gjermani), Prishtinë - Republika e Kosovës, 2019.
- Pianiste e ansambilit “Celebre” në koncertin e organizuar nga Foajeu Evropian “Les Concerts fu Foyer Europee”, Luxemburg - Luxembourg, 2019.
- Koncert kamertal, Lecco (Milano) - Itali, 2019.
- Koncert kamertal në kuadër të manifestimit “Ditët Shqiptare në Slloveni”, Teatri i qytetit, Kopër - Slloveni, 2019.
- Koncert kamertal në kuadër të festivalit “Festival Musica Europa” organizuar nga Filharmonia e Sofies, Sofie - Bullgari, 2019.
- Koncert solistik dhe kamertal në Nikolaisaal, Potsdam – Gjermani, 2019.
- Koncert recital në Marchenvill, Eberswalde afër Berlinit - Gjermani, 2019.
- Koncert recital, Berlin - Gjermani, 2019.
- Koncert solistik dhe kamertal në Association Parlementaire Européenne, Strasbourg - Francë, 2019.
- Koncert kamertal në kuadër të manifestimit “Ditët Shqiptare në Slloveni” në Katedralen e Kopërit, Kopër - Slloveni, 2018.
- Koncert kamertal, pianiste e ansambilit “Celebre” organizuar nga Ambasada e Kosovës në Tiranë, për nder të 10 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës në Akademinë e Arteve të Bukura, Tiranë - Shqipëri, 2018.
- Koncert kamertal, pianiste e ansambilit “Celebre” në koncertin e organizuar në kuadër të Festivalit Ndërkombëtar “Ditët e muzikës kosovare”, Prishtinë - Republika e Kosovës, 2018.
- Koncert recital në Hause Museum Pancho Vladigerov dhe masterklasë me studentët e Akademisë së Muzikës në Sofie, Sofie – Bullgari, 2018.
- Koncerte recital, organizuar nga Foajeu Evropian “Les Concerts fu Foyer Europee”, Luxemburg – Luxembourg 2018.
- Koncert solistik dhe kamertal, Bad Honnef dhe Dortmund - Gjermani, 2017.
- Koncertin recital, Vjenë - Austri, 2017.
- Koncert recital, Berlin – Gjermani, 2017.

- Koncert recital në Castle of the town, Storkow (Mark) afër Berlinit – Gjermani, 2017.
- Regjistrimi i CD-së me vepra të njohura të kompozitorëve botëror L. van Beethoven dhe F. Chopin në “Mozart Hause”, Vjenë - Austri, 2017.
- Koncert kamertal, Berlin - Gjermani, 2017.
- Koncert recital në katedralen St. Nikolai në Potsdam dhe Berlin - Gjermani, 2016 dhe 2017.
- Koncert si soliste dhe shoqëruese në piano në OJI HALL – Ginza, Tokyo - Japoni, 2016.
- Koncert kamertal, pianiste e ansambllit “Celebre”, Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë - Republika e Kosovës, 2015.
- Koncert solistik me Orkestrën Simfonike të Filharmonisë së Kosovës me dirigjent Toshio Yanagisawa (Japoni) – Prishtinë, Republika e Kosovës, 2015.
- Koncert recital, organizuar nga Ambasada e Kosovës, Berlin – Gjermani, 2015.
- Soliste dhe shoqëruese në piano në koncertin e organizuar nga Shoqata Ndërkombëtare Frederic Chopin, Vjenë – Austri, 2015.
- Koncert recital në Rezidencën e Kontit Oto Fon Bizmark, organizuar nga Shoqata Ndërkombëtare Frederic Chopin, Reinbek, Hamburg - Gjermani, 2014.
- Soliste dhe pianiste e ansambllit kamertal “Celebre”, në Festivalin Ndërkombëtar Chopin Piano Fest, Prishtinë - Republika e Kosovës, 2014.
- Koncert recital për nder të 6 vjetorit të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, organizuar nga Ambasada e Kosovës, Berlin – Gjermani, 2014.
- Soliste në piano në koncertin tradicional organizuar nga Forcat e Armatosura të Gjermanisë, Naumburg - Gjermani, 2014.
- Soliste në piano në koncertin tradicional organizuar nga Forcat e Armatosura të Gjermanisë në Nikolaisaal, Potsdam - Gjermani, 2014.
- Mentore e pianos në Akademinë Muzikore Verore Evropiane dhe pjesëmarrëse në piano në Gala koncertin internacional të profesorëve, Prishtinë - Republika e Kosovës, 2013.
- Koncert recital në Festivalin e IX-të Ndërkombëtar të Kulturave Nacionale, Shën Petersburg - Rusi 2013.
- Koncert recital organizuar nga Universiteti Jianghan, Wuhan-Kinë, 2013.
- Soliste dhe pianiste e ansambllit kamertal “Celebre” në Festivalin Ndërkombëtar Frederic Chopin, Prishtinë - Republika e Kosovës, 2013.
- Soliste në piano dhe pianiste e ansambllit kamertal “Celebre”, në koncertin humanitar organizuar në bashkëpunim me Presidencën e Kosovës, Ambasadën gjermane, KFOR-in dhe Rotary International Club, Prishtinë - Republika e Kosovës, 2013.
- Koncert recital organizuar nga “Zonta International”, Reinbek – Gjermani, 2012.
- Koncert recital organizuar nga Universiteti Jianghan, Wuhan-Kinë, 2012.
- Koncert si soliste dhe pianiste e ansambllit kamertal “Celebre”, në Festivalin Ndërkombëtar Chopin Piano Fest, Prishtinë - Republika e Kosovës, 2012.

- Soliste në piano dhe pianiste e ansamblit kamertal “Celebre”, në koncertin humanitar, organizuar në bashkëpunim me Presidencën e Kosovës, Ambasadën gjermane, KFOR-in dhe Rotary International Club, Prishtinë - Republika e Kosovës, 2012.
- Koncert, soliste në piano dhe pianiste e ansamblit kamertal “Celebre”, organizuar nga Shoqata Ndërkombëtare Frederic Chopin, Vjenë - Austri, 2012.
- Koncert recital dhe master klasë me studentët e seksionit të pianos në Kolegjin Mbretëror të Muzikës, Stockholm - Suedi, 2011.
- Koncert recital në Festivalin Ndërkombëtar Frederic Chopin-Gesellschaft Taunus, Frankfurt - Gjermani, 2011.
- Soliste dhe shoqëruese në piano në festivalin ndërkombëtar F. Chopin e organizuar nga Shoqata Ndërkombëtare Frederic Chopin në Vjenë, mbajtur Kartause Gaming - Austri, 2011.
- Koncert recital organizuar nga Iniciativa Kulturore Evropiane për Gjeneratat e Reja, Vjenë - Austri, 2011.
- Soliste në piano në koncertin e organizuar nga Shoqata Ndërkombëtare Frederic Chopin, Vjenë - Austri, 2011.
- Soliste dhe pianiste e ansamblit kamertal “Celebre” në Festivalin Ndërkombëtar Chopin Piano Fest, Prishtinë - Republika e Kosovës, 2011.
- Soliste dhe shoqëruese në piano në koncertin përmbyllës, me rastin e 200 vjetorit të lindjes së kompozitorit Frederic Chopin organizuar nga Shoqata Ndërkombëtare Frederic Chopin në City Hall, Vjenë - Austri, 2010.
- Soliste dhe shoqëruese në piano në festivalin ndërkombëtar F. Chopin organizuar nga Shoqata Ndërkombëtare Frederic Chopin në Vjenë, mbajtur në Kartause Gaming - Austri, 2010.
- Koncert recital në Festivalin Ndërkombëtar Chopin Piano Fest, Prishtinë - Republika e Kosovës, 2010.
- Koncert recital organizuar nga Shoqata Ndërkombëtare Frederic Chopin, Vjenë - Austri, 2010 .
- Koncert recital në Akademinë e Muzikës, Sarajevë - Bosnje dhe Hercegovinë, 2009.
- Soliste në piano në Festivalin Ndërkombëtar Frederic Chopin, organizuar nën patronatin e Presidentit të Austrisë Dr. Heinz Fischer, me rastin e 25 vjetorit të themelimit të Shoqatës Frederic Chopin, Kartause Gaming - Austri, 2009.
- Koncert recital në festivalin Ndërkombëtar Frederic Chopin, Teatri i Operas dhe Baletit, Tiranë – Shqipëri, 2009.
- Koncert recital në Institutin e Kulturës, Sarajevë - Bosnjë dhe Hercegovinë, 2009
- Koncert kamertal në Festivalin Ndërkombëtar të Muzikës Kamertale “Kamer Fest”, Prishtinë - Republika e Kosovës, 2008.
- Koncert, soliste dhe shoqëruese në piano, organizuar nga Ambasada Gjermane në Prishtinë, 2008.

- Koncert recital në Zurich - Zvicër, 2007.
- Soliste dhe shoqëruese në piano me rastin e manifestimit ndërkombëtar “Java e bibliotekës në Kosovë”, organizuar nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Ambasada e SHBA-ve në Prishtinë - Republika e Kosovës, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010.
- Soliste dhe shoqëruese në piano, Akademi Solemne organizuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e Kosovës, Prishtinë - Republika e Kosovës, 2005.
- Koncert, soliste dhe shoqëruese në piano, Gjiilan - Republika e Kosovës, 2003.
- Koncert kamertal në Festivalin Ndërkombëtar të Muzikës Kamertale “Kamer Fest”, Prishtinë - Republika e Kosovës, 2003.
- Koncert, soliste dhe shoqëruese në piano, Akademi Solemne organizuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e Kosovës, Prishtinë - Republika e Kosovës 2003.
- Koncert recital, Pula - Kroaci, 2003.
- Koncert recital, New York - SHBA, 2003.
- Koncert recital organizuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e Kosovës, Prishtinë - Republika e Kosovës, 2002.
- Soliste dhe shoqëruese në piano e solo këngëtarëve më eminent të Shqipërisë, koncert i organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë - Republika e Kosovës, 2001.
- Koncert solistik me Orkestrën Simfonike të Radio Televizionit Shqiptar, me dirigjent Arbër Dhomi, Tiranë - Shqipëri dhe Prishtinë – Republika e Kosovës, 2000.
- Koncert, soliste dhe shoqëruese në piano, “Java e Kulturës së Kosovës”, Gjermani 1997, Turqi, 1998.
- Koncert recital në Akademinë e Arteve të Bukura, Tiranë - Shqipëri, 1995.
- Koncert solistik me Orkestrën Simfonike të Radio Televizionit Shqiptar, me dirigjent Jetmir Barbullushi, Tiranë – Shqipëri, 1994.